



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:079263

Datë: 12.02.2025

Numri i dokumentit: 06838946

P.2019:079264

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - Dega në Kaçanik, Gjyqtari Burim Çaka, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit E.F, i akuzuar për veprën penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.493-10/19 të datës 06.03.2019, sipas detyrës zyrtare më datë 12.02.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Hedhet aktakuza e Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.493-10/19 të datës 06.03.2019, ndaj të pandehurit E.F, i akuzuar për veprën penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, pushon procedura penale për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale sipas nenit 106 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 107 paragrafin 8 të KPRK-së.

II. Pala e dëmtuar për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

III. Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.493-10/19 të datës 06.03.2019, ndaj të pandehurit E.F, i akuzuar për veprën penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e analizimit të shkresave tjera të lëndës ka ardhur në përfundim se në këtë rast kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes penale.

Për veprën penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së, është i paraparë parashkrimi relativ prej 3 viteve dhe dyfishi i asaj kohe paraqet parashkrim absolut nga ndjekja penale, ku në këtë rast nga kryerja e pretenduar e veprës sipas aktakuzës e cila është shënuar se është kryer më datë 06.02.2019, deri në datën e marrjes së këtij vendimi kanë kaluar më tepër se 6 vite.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke u bazuar në nenin 462 paragrafi 3 të KPP, gjykata ka vendosur që palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore – juridike ta udhëzoj në kontest civil.

Për shpenzimet procedurale u vendos konform nenit 453 të KPPK-së

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë dhe konform nenit 106 paragrafi 1 pika 1.5 lidhur me nenin 107 paragrafi 8 të KPRK-së u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2019:079264, datë 12.02.2025

Gjyqtari:

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.